



## REPUBLIKA E SHQIPËRISË

PROKURORIA E PËRGJITHSHME  
Nr. 2803/7 Prot. Datë 15.12.2011

MINISTRIA E BRENDSHME  
Nr. 3197/6 Prot. Datë 20.02.2011

SHKOLLA E MAGJISTRATURËS  
Nr. 3301/1 Prot. Datë 13.03.2011

## MARRËVESHJE

### “Për Trajnimin Vazhdues të Oficerëve dhe Agjentëve të Policisë Gjyqësore”

Prokuroria e Përgjithshme, Ministria e Brendshme, në bashkëpunim me Shkollën e Magjistraturës, duke vlerësuar se ngritja e vazhdueshme profesionale e oficerëve dhe agjentëve të Policisë Gjyqësore të strukturave që kanë në varësi administrative:

është një nevojë e domosdoshme në luftën kundër kriminalitetit;

është një nevojë permanente në synimet për të arritur objektivat individuale;

do të ketë ndikim në përmirësimin e procesit hetimor të veprave penale;

do të ketë ndikim në garantimin më të mirë të të drejtave dhe lirive themelore të shtetasve gjatë ushtrimit të aktivitetit të tyre,

në mbështetje të nenit 12 gërma “b” të ligjit nr.8677, datë 02.11.2000 “Për organizimin dhe funksionimin e Policisë Gjyqësore”, (i ndryshuar), neneve 30 deri 33 të ligjit nr.7905 datë 21.03.1995 “Kodi i Procedurës Penale i Republikës së Shqipërisë”, (i ndryshuar), nenit 8 pika “ë” të ligjit nr. 8737, datë 12.2.2001 “Për organizimin dhe funksionimin e Prokurorisë në Republikën e Shqipërisë” (i ndryshuar), ligjit 9749, datë 04.06.2007 “Për Policinë e Shtetit”,(i ndryshuar), dhe nenit 2 të ligjit nr.8136, datë 31.07.1996 “Për Shkollën e Magjistraturës së Republikës së Shqipërisë”,(i ndryshuar), arritën në marrëveshjen e mëposhtme:

## **Neni 1** **Shpjegimi i termave**

1. Oficerë dhe agjentë të policisë gjyqësore janë:

- Oficerët e policisë gjyqësore të seksionit të prokurorisë – jurist apo specialist, në varësi administrative nga Prokuroria e Përgjithshme;
- Oficerët dhe agjentët e policisë gjyqësore të seksionit të prokurorisë ardhur nga shërbimet e polive të mëposhtme;
- Oficerët dhe agjentët e policisë gjyqësore të shërbimit të Policisë së Shtetit, në varësi administrative të Ministrisë së Brendshme;
- Oficerët dhe agjentët e policisë gjyqësore të shërbimit të SHKB të Ministrisë së Brendshme, në varësi administrative të kësaj ministrie;
- Oficerët dhe agjentët e policisë gjyqësore të shërbimit të SHKB në sistemin e Burgjeve, në varësi administrative të Ministrisë së Drejtësisë;
- Oficerët dhe agjentët e policisë gjyqësore të shërbimit të Policisë Ushtarake, në varësi administrative të Ministrisë së Mbrojtjes;
- Oficerët dhe agjentët e policisë gjyqësore të njësive të hetimit tatimor, në varësi administrative të Ministrisë së Financave;
- Oficerët dhe agjentët e policisë gjyqësore të organit të luftës kundër kontrabandës dhe trafikut të paligjshëm, në varësi administrative të Ministrisë së Financave;
- Oficerët dhe agjentët e policisë gjyqësore të shërbimit të Policisë Pyjore, në varësi të Ministrisë së Mjedisit.

2. Institucion publik arsimor, në kuptim të kësaj marrëveshjeje janë:

- Shkolla e Magjistraturës;
- Qëndra e formimit policor.

3. Në këtë marrëveshje me “Bord” kuptohet “Bordi për Organizimin e Trajnimit Vazhdues të Policisë Gjyqësore”.

## **Neni 2** **Parimet e trajnimit**

1. Procesi i trajnimit të oficerëve dhe agjentëve të policisë gjyqësore duhet të sigurojë shpërndarjen e njojurive profesionale në mënyrë të tillë që të sigurohet i njëjtë kuptim mbi dispozitat e ligjit penal, atij procedural penal dhe akteve të tjera ligjore ose nënligjore në fuqi.
2. Procesi i trajnimit duhet të sigurojë shpërndarje të balancuar të njojurive tek të gjithë oficerët dhe agjentët e policisë gjyqësore, pavarësisht nga diferenca e kushtëzuara nga specializimi në punën e tyre.
3. Procesi i trajnimit duhet të sigurojë një trajnim të orientuar sipas nevojave konkrete që kanë oficerët dhe agjentët e policisë gjyqësore.
4. Procesi i trajnimit duhet të sigurojë që krahas njojurive ngushtësisht profesionale, oficerët dhe agjentët e policisë gjyqësore të marrin edhe njouri të lidhura në mënyrë indirekte me profesionin e tyre, apo çdo njouri tjetër të karakterit teknik apo instrumental që rezulton i nevojshëm për ushtrimin e funksionit të oficerit dhe agjentit të policisë gjyqësore.
5. Procesi i trajnimit duhet të sigurojë që hartimi i planeve të trajnimit të bëhet, duke siguruar pjesëmarjen e gjerë të oficerëve dhe agjentëve të policisë gjyqësore.
6. Procesi i trajnimit duhet të sigurojë kontrollin dhe vlerësimin periodik të njojurive.

### **Neni 3 Trajnimi vazhdues**

1. Oficerët dhe agjentët e policisë gjyqësore i nënshtronen trajnimit vazhdues nga Institucioni Publik Arsimor.
2. Periudha e formimit vazhdues është në përputhje me programet mësimore të këtyre institucioneve, të cilat do të përcaktohen çdo fillim viti akademik.
3. Pjesëmarrja në këto trajnime e oficerëve dhe agjentëve të policisë gjyqësore është e detyrueshme.
4. Secili prej institucioneve nënshkrues që ka në varësi administrative struktura policore që gëzojnë atributë të policisë gjyqësore, merr të gjitha masat e nevojshme për të siguruar trajnimin vazhdues të oficerëve dhe agjentëve të policisë gjyqësore në përputhje me detyrimet që burojnë nga neni 12/b i Ligjit nr.8677, datë 02.11.2000 “Për Organizimin dhe Funksionimin e Policisë Gjyqësore”, (i ndryshuar) dhe nga kjo marrëveshje.

### **Neni 4 Fushat e trajnimit vazhdues**

1. Trajnimi vazhdues i oficerëve dhe agjentëve të policisë gjyqësore do të jetë i fokusuar por pa u kufizuar, në njohuritë që duhet të zotërojnë ata për shkak të atributit.
2. Ato do të jenë të orientuara por pa u kufizuar, në ligjin material penal (të fushës së shërbimit) dhe ligjin procedural penal, në teknikat e hetimit, teknikat e mbledhjes së provave, teknikat e përpilimit të akteve, teknikat speciale hetimore, raportet e bashkëveprimit të oficerit/agjentit të policisë gjyqësore me prokurorin, raportet e bashkëveprimit të oficerit/agjentit të policisë gjyqësore me gjykaten, raportet me subjektet e tjera të procedimit penal, si dhe çështje të tjera që do të identifikohej nga Bordi për Organizimin e Trajnimit Vazhdues të Policisë Gjyqësore.

### **Neni 5 Bordi për Organizimin e Trajnimeve**

1. Për organizimin sa më të mirë të procesit të trajnimit vazhdues, ngrihet Bordi për Organizimin e Trajnimit Vazhdues të Policisë Gjyqësore, më poshtë i quajtur “Bordi”.
2. Bordi përbëhet nga:
  - a) Drejtori i Drejtorisë së Inspektimit dhe Burimeve Njerëzore në Prokurorinë e Përgjithshme;
  - b) Zv.Drejtori i Përgjithshëm për Departamentin e Trajnimit Policor në Drejtorinë e Përgjithshme të Policisë;
  - c) Përfaqësues i Ministrisë së Drejtësisë;
  - ç) Përfaqësues i Ministrisë së Financave;
  - d) Përfaqësues i Ministrisë së Mbrojtjes;
  - dh) Përfaqësues i Ministrisë së Mjedisit, Pyjeve dhe Administrimit të Ujraleve;
  - e) Përfaqësues i Shkollës së Magistraturës.

## **Neni 6 Kompetencat e Bordit**

1. Kompetencat e Bordit për Organizimin e Trajnimit Vazhdues të Policisë Gjyqësore janë:
  - a) bordi ka karakter koordinues ndërmjet të gjitha strukturave të përfshira në këtë marrëveshje;
  - b) miraton temat e identifikuara nga Struktura Teknike Mbështetëse që do të trajtohen, përcakton sektorët, oficerët dhe agjentët e të cilëve përfitojnë nga këto tema dhe numrin e ditëve të detyrueshme për trajnimin e oficerëve dhe agjentëve të Policisë Gjyqësore, në një vit akademik;
  - c) harton rekomandimet për Institucionin Arsimor për planin vjetor të trajnimit;
  - ç) përgjedh mes ekspertëve të identifikuar ata që do të përfshihen në procesin e trajnimit;
  - d) bën vlerësimin paraprak të temave të përgatitura nga ekspertët;
  - dh) diskuton aspektet financiare që lidhen me organizimin e trajnimeve;
  - e) identifikon problemet në fushën e trajnimit vazhdues të oficerëve dhe agjentëve të policisë gjyqësore, informon zyrtarisht secilin institucion nënshkrues për problematikat e shfaqura dhe nevojat për ndryshime si dhe bën rekomandimet përkatëse për institucionet përgjegjëse;
  - f) i propozon dhe rekomandon Prokurorit të Përgjithshëm, Ministrit të Brendshëm dhe institucioneve të tjera përgjegjëse, lidhjen e marrëveshjeve të bashkëpunimit me institucione ndërkombëtare të ngarkuara me trajnimin e policisë gjyqësore, si dhe bashkëpunim me universitete dhe institute kërkimore.
  - g) merr përsipër zgjidhjen e çdo problemi tjetër administrativo-teknik që shfaqet gjatë procesit të organizimit të trajnimeve.
  - gj) në muajin Qershor të çdo viti, Bordi pasi ka shqyrtauar nevojat për trajnim dhe buxhetin përkatës të paraqitur nga institucionet sipas paragrafit të dytë të nenit 12, dërgon pranë institucioneve nënshkrues të kësaj marrëveshje, programet e trajnimit të vtit pasardhës dhe kostot orientuese financiare.

## **Neni 7 Drejtimi, vendimmarrja, kuorumi**

1. Mbledhja e parë e Bordit thirret nga Prokurori i Përgjithshëm.
2. Kryetar i Bordit është Drejtori i Drejtorisë së Inspektimit dhe Burimeve Njerëzore në Prokurorinë e Përgjithshme.
3. Në mbledhjen e parë, Bordi cakton një grup pune për hartimin e rregullores së funksionimit të tij. Bordi miraton rregulloren në mbledhjen e tij të dytë.
4. Kryetari merr të gjitha masat për organizimin sa më të mirë të mbledhjeve të Bordit.
5. Bordi mblidhet detyrimisht të paktën dy herë në vit dhe sa herë që propozohet nga njëri prej anëtarëve të tij.
6. Vendimet e Bordit merren me shumicën e 2/3 të të gjithë anëtarëve të tij.

**Neni 8**  
**Struktura mbështetëse**

1. Në mbështetje të Bordit ngrihet Struktura Teknike Mbështetëse. Anëtarët e kësaj strukture caktohen nga secili prej anëtarëve të Bordit, në varësi të nevojave të institucionit që përfaqësojnë.

**Neni 9**  
**Emërimi dhe zëvendësimi i ekspertëve – trajnues**

1. Çdo vit, Bordi, pasi evidenton nevojat për trajnim dhe fushat përkatëse ku do kryhet trajnimi, vendos kriteret për të qenë ekspert trajnues në listën e temave të përzgjedhura nga ai.
2. Bordi përzgjedh kandidaturat për secilën temë. Për çdo temë caktohen dy ekspert-trajnues.
3. Zëvendësimi i ekspertit trajnues bëhet kur materiali i përgatitur nuk është në nivelin e duhur apo për pamundësi objektive të ekspertit për të zhvilluar trajnimin. Për zëvendësimin e ekspertit, Bordi, ndjek përsa është e mundur, të njëjtën procedurë si përzgjedhjen e tij.

**Neni 10**  
**Detyrat e Oficerit dhe Agjentit të Policisë Gjyqësore të trajnuar**

1. Oficeri dhe Agjenti i Policisë Gjyqësore ka këto detyra:
  - a) merr masat e nevojshme për të mos munguar në sesionet e planifikuara trajnuese.
  - b) njofton me shkrim përfaqësuesin e tij institucional në bord për pamundësinë objektive të pjesëmarrjes në sesionin trajnues.

**Neni 11**  
**Detyrat e Institucionit Publik Arsimor**

1. Institucioni Publik Arsimor, në përputhje me aktet ligjore dhe nënligjore që rregullojnë aktivitetin e tij kryen këto detyra:
  - a) merr përsipër organizimin praktik të aktiviteteve të trajnimit vazhdues; har ton programet mësimore dhe planin mësimor vjetor, bazuar në rekomandimet e bordit;
  - b) kontribuon në kryerjen e proceduarve për vlerësimin e nevojave për trajnim të oficerëve dhe agjentëve të policisë gjyqësore;
  - c) ndihmon duke përfshirë në procesin e trajnimit pedagogë apo ekspertë me të cilët ai vet bashkëpunon;
  - ç) ndihmon ekspertët në përgatitjen e temave të kurseve të trajnimit vazhdues;
  - d) ofron infrastrukturën njerëzore dhe materiale për zhvillimin e kurseve të trajnimit vazhdues;
  - dh) lëshon çertifikatat për pjesëmarrësit në një kurs të caktuar trajnimi.

**Neni 12**  
**Rregullime financiare**

1. Çdo institucion që ka në varësi administrative polici gjyqësore përballon shpenzimet për organizimin e kurseve të trajnimit vazhdues në raport me numrin e personave që do të trajnojë, sipas tarifave të përcaktuara me aktet nënligjore në fuqi. Kur trajnimi

organizohet nga Shkolla e Magjistratutës, shpërblimet e ekspertëve bëhen në përputhje me Vendimin e Këshillit të Ministrave nr.271, datë 06.04.2011 “Për veprimtarinë akademike, në zbatimin e programit të formimit fillestar dhe vazhdues, në Shkollën e Magjistraturës”.

2. Në mbledhjen e fundit të vitit, çdo Ministri duhet të informojë Bordin për nevojat specifike për trajnim dhe buxhetin që do t'i akordohet trajnimit të oficerëve dhe agjentëve të policisë gjyqësore.

**Neni 13**  
**Dispozita zbatuese**

1. Me këtë marrëveshje njihen të gjithë punonjësit e Prokurorive dhe të Policisë së Shtetit.

**Neni 14**

1. Me kontrollin e zbatimit të detyrimeve të përcaktuara në këtë Marrëveshje, ngarkohen Drejtori i Drejtorisë së Inspektimit dhe Burimeve Njerëzore pranë Prokurorisë së Përgjithshme, Drejtori i Përgjithshëm i Policisë së Shtetit dhe Drejtori i Shkollës së Magjistraturës.


**Neni 15**  
**Hyrja në fuqi**

Kjo Marrëveshje hyn në fuqi një muaj pas nënshkrimit të saj.

**PROKURORI I PËRGJITHSHËM**



**MINISTËR I BRENDSHËM**



**DREJTORI I SHKOLLËS SË MAGJISTRATURËS**

**MARIANA SEMINI**

